

PASKAJORJA NË FUNKSION KRYEFJALOR¹ (SIPAS FOLKLORIT)

I. KALLËZUESI ËSHTË NJË FOLJE KALIMTARE E DIATEZËS PËSORE

1) Kallëzuesi është një folje e të kumtuarit

Prej foljeve që tregojnë të kumtuar, paskajoren në funksion kryefjalor e marrin foljet *shkruej* dhe *them* në vetën e tretë njëjës në diatezë pësore; si pjesë kryesore të ndërtimit me paskajore, ato përdoren kryesisht në kohën e kryer të mënyrës habitore, ose në formën e mbipërbërë të saj; por hasen edhe format e së kryerës të dëftores e të dëshirores. Në ndërtimin *qenka shkruej + paskajore*, *qenka thënë + paskajore* etj., foljet-kallëzues të pjesës kryesore të ndërtimit marrin kontekstualisht kuptimin modal të shprehjes së vullnetit okult: *është vendosur* (qenka vendosur). Si veprues nënkuptohen fjalët *perëndia*, *zoti*, *fati* etj. në rasën rrjedhore me parafjalën *prej* a në rasën emërore me parafjalën *nga* (*prej perëndisë*, *nga perëndia*), që edhe mund të shprehen gjuhësisht:

Kenka shkruej prej perëndisë /⁺ **m'u da** robi për së gjalli/⁺ **me marrë** rrugën për gyrbet (Këngë popullore); Se jeshtu, tha, *kenka shkruej*, /⁻ Me Turki, tha, **me luftue**, /⁺ **Me luftue** e **me** i **farue**, /⁻ Pesdhetë për një **me u pague** (Këngë popullore historike, Tiranë, 1956, 243); Lemia nanës amanet, /⁺ Amanet mos kaj për mue, /⁻ Se qeshtu *koka kanë shkruej*; /⁺ Ti n'pleqni **me metë** pa mue, /⁻ Dyert e hallkit **me** i **kërkue** (K.p.h. 235); — Udha e marë, o Çetobashe Muja, /⁺ udha e marë, o Tale Budalina! /⁻ si n'koftë *çkruej* djali **me** na **dekë**, /⁺ tridhetë hoxhë, po thotë, unë kam me i mledhë, /⁺ n'vorre t'turqve, thotë, kam me ta çue; /⁺ si n'koftë *çkruej*, thotë, djali **m'u shnoshë**, /⁻ Kam Dylberen për hajr me ja ba (Këngë kreshnike, Prishtinë, 1974, 238); Kuj *ju ka shkruej me dekë* me lak n'fyt, n'tokë as n'ujë s'ka m'u mytë; Kuj *ju ka shkruej me dekë* prej pushke, nuk des prej mushke (Fjalë të urta e thënie popullore, Prishtinë, 1975, 50); Hajt, mor

¹ Ky është një fragment i shkëputur i një punimi më të gjerë me titull „Funksionet sintaksore të ndërtimeve me paskajore në të folmen popullore dhe dialektore“ (në bazë të materialeve folklorike).

Kurt, qenin ç'po e lut, /⁺ Epi hallkat me barut, /⁻ Me barut e me fishekë, /⁺ N'Kergeçik *kanka thanë me mbetë* (Këngë pop. hist. 264).

Krahas paskajores, përdoret edhe lidhorja: Bije shi, bije rafmet, /*Qenka thanë të bajmë dyfek*, / T'bajmë dyfek me asqer devlet (K. pop. hist. 220).

Pothuajse të njëjtin kuptim shpreh edhe ndërtimi *është e shkruar + paskajore*, ku paskajorja ka të bëjë me kallëzuesorin *e shkruar* të kallëzuesit emëror (*është e shkruar*), që i jep këtij kuptimin *është vendosur nga fati, nga zoti etj.*, domethënë një kuptim modal të shprehjes së vullnetit okult:²

At'herë mreti lypi falje edhe u penue për veprën qi e kish ba, qi kish dashtë me e hupë djalin pa faj, se ish *kanë e shkrueme me* ja **marrë** djali çikën, qysh ja kishin ba pleqt niqahin përpara (Pr. Dren. I, 112).

Me kuptimin e mësipërm të foljeve *them e shkruaj* përdoret rrallë edhe folja e procesit mendor *gjykoj*; në këtë rast tregon shprehje të vullnetit, prandaj përdorimi i paskajores „urdhërohet” nga vetë modaliteti i saj: „Se për mue *kenka gjykue*, /Krahi i djashtë m e m'u v a r r u e” (K. pop. hist. 281).

Në të folmen popullore dhe dialektore paskajorja del edhe pranë foljeve *përmend e flas* (në vetën e tretë njëjës në diatezë pësore):

Unë n'odë jam kanë, veç z'di ç *është permen m'i thirrë* Hasanavit n'darsum (ligjërim dialektor); — Prâm s'u fol unë **me shkue** n'mal për dru (ligjërim dialektor). Në rastin e fundit mund të bëhet fjalë edhe për funksion kundrinor të paskajores.

2) Kallëzuesi është një folje e perceptimit shqisor

Nga foljet e perceptimit shqisor që marrin paskajore në funksion kryefjalor, kemi shënuar foljet *shoh* dhe *ndiej* (dëgjoj) në vetën e tretë njëjës të diatezës pësore: *shihet, ndihet*. Zakonisht me këto folje, përbrenda periudhës, përdoren mënyrë të tjera, kryesisht dëftorja e habitorja, kurse paskajorja rallë:

Nuk *asht ndie* kurr **me vra** vllau të vllan (J. Rr., Sintaksi shqyp, Shkodër, 1942, 78); Ku *është n'i me vra* buri thmín (ligjërim dialektor); Nuk *është pa*, as *është ndigjue me luftue* dhetë burra me 'i grue (Këngë popullore).

3) Kallëzuesi është një folje e perceptimit mendor, e procesit mendor

Pranë foljesh që tregojnë të kujtuar, të marrë vesh, si: *më kujtohet, më bie ndër mend* (më bie në mend), *më shkon ndër mend* (më shkon në mend), të përdorura si shprehje të vetës së tretë njëjës, paskajorja është në

² S. F l o q i, *Periudha me fjali të varur kryefjalore*, SF, 3/1965, f. 35.

funksion kryefjalor. Me kuptimin e foljes *më kujtohet* a të shprehjes *më bie ndër mend*, përdoret në ndonjë të folme folja mesore (*më fteket*).

Paskajorja është në funksion kryefjalor pranë foljes *kujtoj*, kur përdoret si njëvetore në formën joveprore dhe kur prihet nga trajta e shkurtër e përemrit vetor të tri vetave në rasën dhanore; bashkë me trajtën e shkurtër përdoret herë-herë edhe trajta e plotë a një emër në dhanore; në diatezën mesore kjo folje përdoret edhe si vetore dhe atëherë është kalimtare e zhdrejtë. Përemri a emri në rasën dhanore tregon personin — kryefjalë logjike të perceptimit; pa këtë gjymtyrë folja mund të merret si vetore e vetës së tretë (ai *kujtohet*) dhe nuk përbën kallëzues të një fjalie pa kryefjalë.³ Në këtë përdorim paskajorja është në funksion kundrinor — është e ngjashme me një kundrinë të zhdrejtë parafjalore: *u kujtova për këtë*.

Të shënojmë disa shembuj, ku paskajorja është në funksion kryefjalor: Çysh *s'm'u kujtue me ju lutë* ma përpara per buk (ligjërim dialektor).

Me kuptimin e foljes *më kujtohet*, të shprehjes foljore *më bie ndër mend*, siç u tha, përdoret folje mesore *me fteket*. Në ndërtimin *më fteket + paskajore*, paskajorja është në funksion kryefjalor. Folja *më fteket* përdoret si folje njëvetore:

Po përpara se me fillonë të mbejëlli, *i ishte ftekë më vou* një kllapeëjçë për me zanë donji rabec ja donji shpezë qetër (Fsh, Pr. I, 102); (Për se më thret?) Gje ma dha shpatën e më boni zaptije, po sot mos *i osht ftekë me* ma **pre** kreëjt? (Fsh, Pr. II, 137).

Me kuptimin e një foljeje të perceptimit mendor përdoren edhe shprehjet *më bie ndër mend* (*më bie në mend*), *më shkon ndër mend* (*më shkon në mend*), që janë të ndërtuara nga foljet jokalimtare *bie*, *shkoj* në vetën e tretë njëjës + emri *mend* me parafjalët *ndër a në*. Këto përdoren me dhanore të vetës, që tregon personin subjekt-logjik të perceptimit:

Zoti zhdryptë rahmet n'shpirtin e ati qi *i ka ra n'men me i bashkue* mish edhe pasul bashkë (Pr. Dren. II, 111); (Vehet ujku i shkretë me ikë kah dera, kur që ia merthen dashi me brina;) Del n'oborr e gomari e përciell me dy shtjelma të mirë e nuk *i bjen në mend me shikjue* ma mbrapa (Fsh, Pr. I, 111); (Si me dalë? si me dalë?) *Më ra ndër mend me thye* një arrë... (Fsh, Pr. II, 321); — Jo, mos kjani — u thotë — se djali s'ka le ende, e mue as *nepër mend s'më ka shkue* me marrë bijë prej këtij konaku (Fsh, Pr. II, 325).

Këto shprehje përbrenda fjalisë së pavarur mund të marrin një kundrinë të zhdrejtë parafjalore, shprehur me emër a përemër me parafjalën *për*, gjë që lë mundësinë e interpretimit të paskajores edhe në funksion kundrinor të zhdrejtë: Kur *na bjen në mend për nana*, /Dalim kqyrim kah shkon hana,/ Kur *na bjen në mend për baba*, /Dalim e kqyrim

³ S. Floqi, art. i cit. f. 16.

kah shkon vadaj/ Kur na bjen në mend **për motra**/ Himë në shpi e rrimë në votra; /Kur na bjen në mend **për thmi**,/ Shkojmë e himë me kamë në hi (Këngë popullore).

Por kur fjala *mendja* përdoret pa parafjalë dhe në trajtën e shquar të rasës emërore, atëherë paskajorja pranë shprehjes foljore *më shkon mendja* nuk është në funksion kryefjalor; në këtë rast kemi të bëjmë me paskajore në funksion kundrinor — ajo është adekuate me një kundrinë të zhdrejtë parafjalore: *më shkoi mendja për këtë*: Tuj shkue, i shkoi mënja me u kthye e me kqyrë bunarin se mos kish ardhë uji e po mos ish shëmë nakun (Pr. Dren. II, 50).

Për arsye gjymtyrimi aktual togjet *në mend, ndër mend, nëpër mend* mund të dalin të përmbysura: Kurrkuj *n'mend s'po i bjen me qindrue* (Fsh, Ep. legj., I, 165).

4) Kallëzuesi është një folje e dëshirës a e shprehjes së vullnetit

Folje me kuptim leksikor të dëshirës e të shprehjes së vullnetit që marrin paskajore në funksion kryefjalor, ka pak në të folmen popullore dhe dialektore. Përdorimin e paskajores pranë këtij grupi semantik foljesh e paracakton modaliteti i tyre. Nga këto, përdoren foljet me kuptim leksikor të *nevojës, të domosdoshmërisë, të vullnetit: duhet, lypet, vendoset* në vetën e tretë njëjës të diatezës pësore.

Trajtat joveprore të foljes *dua*, në vetën e tretë njëjës, pothuajse gjithnjë paraqiten me kuptim leksikor të zbehur dhe funksionojnë më tepër si folje gjysmëndihmëse me vlerë modale. Nga këto, *duhet* është gramatikalizuar gati krejtësisht dhe është shndërruar në një trajtë të ngurosur, në njëfarë pjesëze modale të domosdoshmërisë, të detyrimit: e ngurosur për mënyrën, për vetën dhe për kohën.⁴

Ndërtimet e trajtave joveprore të foljes *dua* me paskajore më tepër përbëjnë bashkime analitike me raporte të paktën formalisht kundrinore: Ban s'ban, **iu desht** vajzës *me ia dhanë* fyellin e *me ia dhanë* besen (Fsh, Pr. II, 299); E kshtu **ju desht** priftit *me la paret* e pulave e kshtu katundarja shkoi n'pun t'vet... (Fsh, Pr. I, 274); (— I kemi pru kto vajza se s'kemi mujtë me i nalë për djem tonë.) Ju kemi çue fjalë baballarve t'tyne edhe s'i kanë nalë, e ju epni e interesonu si për evlad tanin, se m'kanë ra n'orë edhe na **u dasht** *me jau gjetë* venin diku (Pr. Dren. 164); S'mujt me i ra ne te e **iu desht** *me ia lshue* edhe tridhetë dugajë tjera (Fsh, Pr. II, 374); N'kohë t'Turqisë, kur kanë ardhë e kanë fillue me i kthye njerzit n'fe t'Isllamit, n'rën t'parë **asht dashtë** *me i dijtë* shartet e Turqnisë (Pr. Dren. II, 113); — **A kanë dashtë** (= ka qenë dashur) *me ja ditë* hujin pelës (Pr. Dren. II, 83); — **A kanë dashtë** *m'u lutë* për s'kfjellti, e jo kur vrâhet (Pr. Dren. II, 182); Kur lehshin qënt, u tutsha qi p'e njekun ukun e po vjen uku e po bjen

⁴ S. F l o q i, *art. i cit.*, f. 19.

n'bnar tu un e **m'u kish dashtë** *m'u kapë* me ukun e *m'u mytë* me tã (Pr. Dren. II, 130); Po çë **po të lypet**, more bir, *me e dijtë...* (Pr. II, 205); Hajni pranoi kabahatin e **u venos** *me pague* damin (ligjërim dialektor).

Përveç foljeve *shkruaj, them*, me kuptimin e shprehjes së vullnetit okult, përdoret edhe folja *vij*, kryesisht në kohën e shkuar, që ka si veprues kundrinën e zhdrejtë parafjalore: *nga zoti, prej zotit, nga perëndia, prej perëndisë* etj.:

— Oj grue, na *ka ardhë* p e j p e r e n i j e ka 'i herë **me lypë** ka ni sën shka t'na don zemra, krejt shka ka n'dynja (Prozë popullore nga Drenica, I, 136); Ni ditë i *erdh* p r e j p e r e n i j e qi **me lypë** n'kët dynja çka t'don (aty, 136)

Në funksion kryefjalor është paskajorja edhe në ndërtimin: — M e e m ë r t ' p e r e n i s ë t ' k a a r d h ë **me** jau **plotsue** ka ni dishirë (Pr. pop. nga Dren. I, 136), ku kemi të bëjmë më tepër me një shprehje idiomatike që ka kuptimin „është vendosur”, „është caktuar” /nga perëndia/.

II. KALLËZUESI ËSHTË NJË TOGFJALËSH I NDËRTUAR NGA NJË FOLJE KALIMTARE + NJË EMËR NË TRAJTË TË PASHQUAR

Foljet kalimtare zakonisht shërbejnë si folje-kallëzues të një fjalie kundrinore — adekuate me një kundrinë të drejtë a të zhdrejtë, parafjalore ose jo. Folja kalimtare *kam* dhe folja *marr* në togfjalësha të caktuar mund të marrin një paskajore në funksion kryefjalor. Kjo ndodh, kur këtyre togfjalëshave të përdorur me vlerën e një foljeje njëvetore, u mungon kryefjala. Paskajorja vihet në korrelacion me këta togfjalësha, duke kryer funksionin e kryefjalës së tyre. Në të folmen popullore dhe dialektore togfjalësha të tillë janë: (*s*) *ka hije*, (*s'*) *ka lezet*, (*s'*) *ka nevojë*, (*s'*) *ka hesap*, (*s'*) *ka llogari*, (*s'*) *ka kuptim*, (*s'*) *merr bojë* etj. Këta togfjalësha, duke u përdorur në vetën e tretë njëjës, pa iu referuar ndonjë kryefjale të caktuar, janë bërë shprehje njëvetore, kur si të tilla marrin një paskajore, atëherë kjo bënë funksionin e kryefjalës së tyre; por, disa prej tyre kur përdoren si shprehje vetore, atëherë paskajorja nuk është në funksion kryefjalor, por në funksion kundrinor, asaj i përgjigjet një kundrinë e zhdrejtë me parafjalë: (*s'*) *kam nevojë* p e r k e t ë: (Ne s'kemi gjak të keq.) *S'kemi nevojë* **me** na **marrë** gjak (Pr. Dren. I, 99), *S'ke nevojë*, babë, dukat **me dhanë**. .. (Ep. legj. 284) *S'ke nevojë*, Mujë, **me u harxhue**... (Ep. legj., 271).

Të shënojmë ndonjë ndërtim me paskajore në funksion kryefjalor: *S'ka nevojë* **me livrue** ti (Pr. Dren. I, 94); Njeri i mirë vetë kallxon me punë, e *s'ka nevojë* **me folë** as ti, as unë (Fjalë të urta..., 96); — Nanë, e kam ble — tha — ni vneshtë t'mirë diku, po *me t'marrë* ty e *m'e lanë* gruen **s'po ka kuptim**, *m'e marrë* gruen e *me t'lanë* ty **s'po ka kuptim** as kshtu (Pr. Dren. I, 76); Nuk **merr bojë**, o bir, *me u perzie* nermje vllaznive, ata nreçen vet (ligjërim dialektor); — He, — thotë njani — na po shkojmë edhe po ja

bajmë kshtu: Un po tham: „Kti i thonë Demë Buleta”, e ti thuej: „I **ka hije** m’u çartë blea”; — I **paska hije** me u çartë blea — ja priti i pari (Pr. Dren. II, 86); — Nuk t’**paska hije** me i ra me mjekërr qytelisë (aty, f. 31); *Me nga vrap s’ka hesap*, e me hec-ngec (Fjalë të urta..., f. 76); *Me shterrë* pusin për ni peshk, **s’ka hesap** (aty, f. 77): — S’ban, bre mik, ashtu se nuk **merr bojë** me prishë trumpin.

Në shembujt me togfjalëshin „ka hije”, „s’ka hije”, siç shihet, kryefjalë e paskajores është kundrina e zhdrejtë pa parafjalë e foljes drejtuese. Më rrallë haset përdorimi pa kundrinë të zhdrejtë paparafjalore; pa kundrinë shprehja „ka hije”, „s’ka hije” përdoret për diçka përgjithësuese, që s’i takon një personi a sendi të veçantë:

Masi e pata edhe përpara mjekërrën, psë me ma ba gjith at lutje, masi **s’paska hije** me i ra qytelisë me mjekërr (Pr. Dren. II, 31); — Bjeri — i thotë kadisë — se po t’i majë vetë, **s’ka hije** me i çue ti ato tesha (Fsh, Pr. II, 354).

III. KALLËZUESI ËSHTË NJË FOLJE JOKALIMTARE

Ka disa folje jokalimtare që përdoren si pjesë kryesore të ndërtimit me paskajore në funksion kryefjalor. Paskajorja pranë këtyre foljeve bën punën adekuate të kryefjalës, në rast se trajta e foljes-kallëzues është në vetën e tretë njëjës dhe mund të marrë në kushte të caktuara një kryefjalë, të shprehur me emër, përemër a fjalë të emëruar në rasën emërore.

Foljet jokalimtare me të cilat paskajorja hyn në marrëdhënie kryefjalore, në përgjithësi tregojnë të *ndodhur*, të *ngjarë*, të *rastisur*, të *përkitur*, të *pëlqyer*, të *mbetur*, si: (më) *ndodh*, (më) *takon*, (më) *bie*, (më) *ka rënë*, (më) *bie hise*, (më) *pëlqen*, (më) *mbetet*, (s’) (më) *mbetet*.

Si folje që tregon rastisje, përdoret edhe folja *qëllon*, përkatësisht (më) *qëllon*, sidomos në kohën e kryer.

Ne kemi konstatuar se në gjuhën e folur përdoret më tepër shprehja e pandashme foljore *bën vaki*, që tregon të *ndodhur*, të *rastisur* etj. Këto folje e shprehje foljore shoqërohen zakonisht me dhanore të vetës, me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, ose me trajtë të shkurtër e me të plotën a një emër etj. njëherazi. Ka raste kur ndonjëra prej këtyre foljeve mund të përdoret edhe pa dhanore të vetës, dhe atëherë tregohet diçka në mënyrë të përgjithshme.

Foljet (më) *takon*, (më) *bie*, (më) *ra*, (më) *bie hise* tregojnë të *përkitur*. Ajo që shprehet me paskajore, i përket dhanores së vetës:

Masi *jâm dhân* për fjalë teme, *m’takon me u dhânë* ka ni kat tesha (Pr. pop. nga Dren. II, 238); — Masi e paske gjuejtë deven edhe e paske lejen me gjuejtë me skyfter ty t’*takon me e marrë* deven (Pr. pop. nga Dren. II, 67); — A *po m’bjen me e pague* gjakun, se nuk e kam ba me kast (Pr. pop. nga Dren. II, 237); Ramadani, edhe pse ish plaku i dheut, masi ish puna e vllaut tij, nuk *i rake me e pleqnue* vetin (Pr. pop. nga Dren. II, 238);

— E, masi s'e merr zarar, — tha Ramadani — si *t'bjën* ty **me** e **marrë** fitimin? (Pr. pop. nga Dren. II, 244); — Teshat po t'i ap — ia kthen çobanësia — por ato tuejat s'i due, pse kenke grue sojnikë e *po t'bjën me hiekë keq* (Folklor shqiptar, Pr. pop. II, 405); U hap zani për kater anët per nuse qi *i kishte ra me e marrë* djalit të plakut e per pajë qi kishte pru me vedi, e s'foli ma kush keq per te (Folklor shqiptar, Pr. pop. II, 148); Mjaft *i ra me hekë* kti djalit, po ma s'mrami fitoi (Pr. pop. nga Dren. II, 268).

Kjo folje përdoret për të treguar edhe *një ndodhi*, ngjarje të rastësishme, eventuale, si: (E muer udhtari edhe at pupel e e shtini ne krahnor të vet e mandej vijoi rrugën.) *I ra me kalue* në breg të detit (Folklor shqiptar, Pr. pop. II, 284); Ni ditë i ra puna Hysenit e po do me shkue n'Prishtinë.) U gzue fort qi *po i bjën me e pa* edhe jaranin e ti t'vjetër, Sylën (Pr. pop. nga Drenica, II, 30); Nji ditë *i ra me ndejë* në bashkim me shokë (Folklor shqiptar, Pr. pop. II, 223).

Duket sikur folja jokalitmare *bie (më) bie*, para se të përdorej me këtë kuptim, do të ketë pasur pranë emra të tillë, si: *puna, rasti, hise*, që kanë një kuptim shumë të përgjithshëm; këta ndonjëherë edhe përdoren bashkë me foljen: *(më) bie puna, (më) bie rasti, (më) bie hise* (= më rastisi) etj.: Ramadan Shabani ish kanë dalë n'Malsi edhe *i bje hise me e da* këtë pleqni (Pr. pop. nga Dren. II, 241).

Folja *ndodh* dhe shprehja foljore *bën vaki* përdoren për të treguar ngjarje të zakonshme ose ngjarje të rastësishme. Folja *ndodh* përdoret me ose pa kundrinë të zhdrejtë të rasës dhanore:

Ni pazari *i ndodhi me u nisë* për ngut e s'pat marrë buk n'shpi (Pr. Dren. II, 111); Kur **ndodhke** *m'u zatetë* dy palë krushqi, u rrokshin rrotelat e dy palë krushqve nërmje veti trup me trup (Pr. Dren. II, 214).

Ashtu si edhe folja *ndodh*, edhe shprehja foljore *bën vaki*, që ka denduri përdorimore, pa kundrinë të zhdrejtë të dhanores, përdoret për diçka përgjithësuese, që s'i takon një personi të veçantë: kurse me kundrinë të zhdrejtë, fakti që tregohet nga paskajorja i referohet një personi të veçantë:

— A **ban vaki** *ma kanë* kaq elierze! (Pr. Dren. I, 248); Neziri kish pas nî qi **ban vaki** *me u çartë* edhe njerzit prej gjâsë (Pr. Dren. II, 100); Edhe *me pi* edhe *mos m'u pi*, rrallëherë **bân vaki** (Fjalë të urta... f. 24); Me pasë kanë nër udhë, **kish ba vaki** *me t'kapë* me zor se t'kish ngrehë zhag (Pr. Dren. II, 226); — Hajt na qoftë me hajr, po mos na dali nonji ngatërresë, **mos t'bjë vaki** *me e hangër* gjarpni (Fsh, Pr. III, 520); „Çou Halil në mejdan me dalë /e deri sot **vaki nuk ka ba/** i gjalli të deknit mejdan *për me i lypë* (Epika legjendare, T., 1966, f. 443).

— S'e di, se kurr **s'm'ka ba vaki** *me i ra* deri sod (Pr. Dren. II, 123); — I kom thonë — tha — or bir, më tha le të mçifet, se ka shenjë të bukura djali jot, **s'em ka bo vaki** *mu me u mçefë* me shtatë peshqe qi e kanë hongër gjañin tat... (Fsh, Pr. III, 357).

Folja *(më) qëllon* në të folmen popullore dhe dialektore si folje njëvetore, e ndjekur nga paskajorja në funksion të kryefjalës, ndeshet

rrallë: Edhe neve na **ka qillue** shpesh *mos me pasë* buk n'sofer (ligjërim dialektor).

Personin në rasën dhanore kërkohet edhe foljet (*më*) *pëlqen*, (*më*) *mbetet*; kjo e fundit në fakt është folje semideponente;⁵ disa trajta të saj janë të diatezës mesore, të tjerat të diatezës veprorë. Kuptimi leksikor i foljeve të mësipërme „urdhëron” përdorimin e trajtave të mënyrës lidhore a të paskajores së tipit *me punue*:

Po rrëm ktu, se **po na pelçen** *m'i ngue* çito kângë (ligjërim dialektor); Shka **po m'pelçen** *me nejtë* ner çit hije (ligjërim dialektor); E nget me pa tu shpija; por shpinë e gjen të plaçkitun e **s'i kishte mbetë** *me jetue* mâ...; — Rri tu axhaku, se **s't'ka metë** *me dalë* as tu pragi derës (ligjërim dialektor); Tash ban çka t'duesh edhe me mue se **s'm'ka metë** *me rrnue* gjallë (Pr. Dren. I, 262).

Në kuptimin „*nuk më përket mua, nuk më mbetet mua*” përdoret folja *imtoj* (në vetën e tretë njëjës): Çou e shko n'punë tâne, se nuk **t'imton** *tý me* na *msue* neve (ligjërim dialektor).

Në funksion kryefjalor paskajorja mund të merret gjithashtu pranë togfjalëshave të ndërtuar nga folja jokalimtare *bie* (*rashë*) + emër në trajtë të pashquar: *më bie huj, më bie çef*:

Kur *t'i bijë huj* djalit *gji me pi*, /lang sheqerit i ap sa t'duej m'u ngi;/ kur **t'i bijë huj** djalit *për me fjetë*, / n'petë t'sylahit e vndoj me fjetë (Fsh, Epika legj., 242); (Ish kân vra 'i herë njani n'krye e i qesin syt xhixha.) Nji ditë shkon n'mal me ni shok e i **bjen huj** *m'e dhezë* duhanin (Pr. Dren. II, 133); —Kur jam kân shtatân me tâ, limoni i kojshis ngat, afër kronit, tuj marrë ujë, e pashë limonin edhe **m'ra huj** *me thithë* ujt e limonit (Pr. Dren. II, 218); Kish punue koxha shum dit e i **kish ra huj** *per me hangër* mish (Pr. Dren. I, 111); Se n'mehane du me hi, / **M'ka ra qef**, bre, pak *me pi* (K. pop. të Ril. Kombëtare, Prishtinë, 1978, 129).

Por konstrukti „*më bie huj ose më bie qejf + paskajore*”, pavarësisht nëse merret si kryefjalë ose jo fjala *huj*, mund të trajtohet edhe si konstrukt me paskajore në funksion kundrinor, ku paskajorja është adekuate me një kundrinë të zhdrejtë parafjalore: Valla **m'ka ra huj** *për mish* e s'kam hangër buk moti (Pr. Dren. I, 303); — Tybe, Mujën unë s'e kam thirrë, /po Muja vesht e ka marrë;/ shumë Muja po ka dert, / *për hena* të mira **huj i ka ra**, / tek asht ardhë për me ngranë (Fsh, Ep. legj., 542).

IV. PASKAJORJA NË FUNKSION KRYEFJALOR KA TË BËJË ME KALLËZUES EMËROR

1) Kallëzuesi emëror ka si kallëzuesor një emër

Numri i emrave që përdoren në funksion të pjesës emërore të kallëzuesit emëror, kuptimi leksikor i të cilëve kërkon paskajore, relativisht

⁵ E. Ç a b e j, *Hyrje në studimin krahasimtar të gjuhëve indoevropiane*, Prishtinë, 1972, f. 179.

është i vogël. Kallëzuesori ka të bëjë me foljen gjysmëndihmëse këpujore *jam* dhe foljet gjysmëkëpujore *bëhem*, *mbetem* (në vetën e tretë njëjës). Në përgjithësi pjesa kryesore e ndërtimit me paskajore përmban një vlerësim etiko-moral, emocional dhe intelektual ndaj një fakti eventual, të supozuar, të mundshëm etj., që shprehet nga paskajorja.

Sipas kuptimit leksikor dhe gramatikor kallëzuesorët emra mund t'i ndajmë në disa grupe; pra paskajorja përdoret kur pjesa kryesore ka në përbërjen e vet:

a) emrat *zakon*, *adet* (në ndonjë rast përdoren edhe kallëzuesorët *rregull* e *ligj* që janë të gjuhës letrare). Rendi i gjymtyrëve të kallëzuesit emëror është ai i zakonshmi, normal: në fillim këpuja a gjysmëkëpuja dhe pas kallëzuesori:

Asht adet nder male *me* i *falë* nuses ndoi dhanti, e ket punë e ban miqasia (Fsh, Pr. II, 147); N'at kohën e vjetër **kanka adet** qi n'çdo vjet *m'u nrrue* mreti (Pr. Dren. I, 59); N'vakt t'moçm **kishte ken adet**, qi t'u plakmen i zoti i shpisë, *me* e *çue* i biri e *me* e mytë n'ujë (Fsh, Pr. I, 258); — Shuej, mori nuse, zoti t'vraftë! /**S'asht adet** nusja *me folë*,/ se ai asht Gjeto Basho Muja,/ të kem'lutë, nuse, e s'e ke marrë! (Fsh, Ep. legj., 184);

Mas ni kohe u tubuen gra, nuse, çika, sukur qi **â kanë zakon** n'darsum *me lue* edhe *me kcyë* (Pr. Dren. II, 74); N'katun **âsht zakon** qi gratë ma t'vjetra *m'u kanë* baçica (aty, 123); Por, para se m'u martue, **ish kanë zakon** at'herë *me shkue* tu kadija me ba niqah (aty, I, 128);

Kshtu **u ba zakon me** e *marrë* nusen me pesdhetë teri n'niqin vetë (Pr. Dren. II, 114); Mas rrotelave **u ba zakon me dalë** dy vetë e me pri para bajraktarit qi mos me i ba kush gja bajraktarit (Pr. Dren. II, 214).

b) emrat *nder*, *nderim*, *njerëzi*, *burrni*, *trimni*; *marre*, *marrí*, *turp*, *korí*, *poshtërsi*, *poshtnim*, *ligshti*, *faqe e zezë*, *pabesí*, *tradhti*, *maskarallëk*, *budallëk*, *budallakí*; *sevap*, *magbull*, *hallall*, *haram*; *gjynah*, *mëkat*; *mallkim*, *gabim*, *dëm*, *mjerim*, *mërzi*, *fesat*, *taksirat*, *fat*, *nafakë*, *kismet*, *mahi*, *dukat*, *flori*, *serm*, *marifet*, *kryesore* etj. Me këta kallëzuesorë vlerësimi i brendisë së paskajores bëhet kryesisht nga pikëpamja morale, emocionale dhe intelektuale:

— Paj more burra, **s'â marre me punue** n'shpi tane... (Pr. Dren. 170); — Mo, nuse, se **âsht marre** ti *me thanë* jo (Pr. Dren... II, 124); Rri more tu shpija — i thotë — se **asht marre me** të *pa* kush në gjithë at bashkim (Fsh, Pr. II, 191); **Asht marre me ndejë** në farkë djelmt e mbretit (Fsh, Pr. II, 198); — **Asht marre**, Mujo, kshtu *me ba* (Fsh, Ep. legj., 504); — Madhni **asht turp me marrë** ti ke ne, le qi ajo asht memece, nuk di me folë (Fsh, Pr. III, 329); — Pusho more se **asht turp** per ty *me mendue* ashtu... *Me* i *folë* vllaút **asht kori**; *Me* u *folë* e *m'i idhnue* kojshitë **asht kori**; Gjithë **asht kanë kori** *me* ia *kthye* fjalën prinve (Pr. Dren. II, 15); Prej menes madhe **â kanë ligшти** *me* ja *lshue* rrugën krushqve tjerë (aty, 214); *Me* u *kapë* me ma t'ligin se ti **s'â trimni**, po **ligшти** (Fjalë të urta..., 134); ... boll **faqe e zezë âsht me kân** rraktâr (ligjërim dialektor); **Asht budallak me folë** para se me hangër (ligjërim dialektor); **Budallakí asht me shkue** ktu e

n'Kievë kâm (ligjërim dialektor); *Me folë është serm, mos me folë është dukat* (Pr. Dren. II, 257); Simas menimit tëm është gabim me i gâ djali babës ja dajës; djali duhet me i gâ kohës (ligjërim dialektor); *A s h t d â m p e r n e s i k a t u n m e u k a p ë* me ni familje (ligjërim dialektor); **Nuk është nër me u perziç**. n'punt e çetrit (ligjërim dialektor); — *Jo nu është fort magbull me i ngue gratë* (Pr. Dren. II, 61); **Marifet është me dashtë** thmín (ligjërim dialektor); **Nuk është hâllal me hângër** prej djerses s'húj (ligjërim dialektor); **Kurrfarë trimnie s'është me mytë** gra e thmi (Fjalë të urta ..., 57); *Me gabue është marri, e me falë gabimin është burri, trimni e edhe njerzi* (ligjërim dialektor); *Me besue është marri, mos me besue është pabesi* (Fjalë të urta..., 74); *Mos me qinrue për tânin, është marri, por kur po qinrojshe, s'po ta di* (aty, 82); *Me e ba t'bardhën zi, s'a s h t b u r r n i* (aty, 74); (Nana t'bisë ka qitë e i ka thanë:) — Përgjysë bora s'â çudi me ra, /s'â çudi, jo, qiella sot **me u da/** copa-copa tani n'tokë me u ba... (Bal. dhe legj., 146); **Me qinrue** për tânin, është trimni, e mos me qinrue, â s h t p o s h t ë r s i (aty, 76); Shum djem *me pasë është kori*, po jo edhe r a h a t i (aty, 126); Shum djem *me pasë është mirat*, por kaniherë **fesat e taksirat** (aty, 126); *Me qinrue për tânin, është lavd* (aty, 76); Shum djem *me pasë është lavd* n'dynjallak, po jo edhe **sefallak** (aty, 126); — Zotsín e menjës, *mos me e kallxue me shkrim, â s h t m j e r i m* (ligjërim dialektor); — Hiçmu qafe! Halili i ka thanë; /Baci Muj-o në harem fjetë â;/ **â merzi** po gjumin *me ja prishë...* (Këngë kreshnike, Prishtinë, 1974, 364); Pej qat'herit dudat si janë metë; /shum **sevap â** n'oborr, tha, *me i pasë/ e me i hangër t'mir-o* shumë qi janë (Bal. dhe legj., Prishtinë, 1974, 213); N'ditë t'zorit *me rrëjtë është sevap* (fjalë të urta..., 88); — E kam pa n'Qitap qi **është sevap me i la** duert deri mas brrylave (Pr. Dren. II, 98); — Mos kshtu se **është gjynah me m'ishue** soll per ni fjalë (Pr. Dren. I, 227) — Po-thotë — masi ve mora, **është gjynah me e da** (Fsh, Pr. III, 531); *Me majtë rob e thmi, s'është mahi; Me majtë shpi s'është mahi* (D. B., Fjalë të urta..., 75); Me e krye urdhnin ashtë detyrë, *mos me krye është tradhti* (aty, 74); M'e rrahë plakun e në lloq m'e lanë, /s'â trimni, tha, dynjaja të shán (Këngë kreshnike, 368); **Marifet s'është për me dashtë**, as kërkush **mos me dijtë gja...** (K. pop. l., 62);

Në shembujt e mësipërme, në varësi nga kuptimi leksikor i emrit dhe nga kuptimi i tij kontekstual, vlerësimi i brendisë së paskajores bëhet nga pikëpamje të ndryshme. Në ndonjë rast, sidomos në proverba, këpuja nuk shprehet; mosshprehja e saj është veçori e këtyre ndërtimeve: **Hall me dekë e hall me metë; Hall me dekë e gjygj me metë; Keq me dekë, e hall me metë; Hall me rrnuë e shtirë me punue** (Fjalë të urta... 45); **Dert me rrnuë e hall me dekë** (ligjërim dialektor).

c) emra me kuptim modal të mundësisë, të pamundësisë, të nevojës, të frikës etj., si: *mymqym, punë, lazëm, detyrë, farz, jasad, frikë, drojë* etj. Kallëzuesori *mymqym* për nga trajta është emër, kurse për nga ana kuptimore afrohet me kallëzuesorin mbiemër në trajtë të femërores: (s') është e mundur. Pranë tyre mund të vihet kallëzuesi emëror në trajtë mohore *s'është punë*, me anë të të cilit tregohet pamundësia për të realizuar

një veprim, gjendje a ndryshim në gjendjen e kryefjalës të shprehur nga paskajorja:

Due prej jush një ujë me marrë nermjet njatyne dy maleve, qi ndeshen shoq me shoq, e ai ujë ishte ilaç, si njallte edhe t'dekunn, por **nuk ishte mymqym me u marrë** ai ujë (Fsh, Pr. I, 246); (—Shum mirë po lujnë edhat tu) **A âsht mymqym me ma falë** një (Pr. Dren. I, 286); — Si t'duesh, se unë s'ta prishi qefin, veç n'**koftë mymqyn** me pritë ni çerek dej sa ta laj... (Pr. Dren., 8); — Mirë e keni psue, pse ju thaç mos shkoni, se ju tradhton daci, pse daci haxhi nuk a bâ asnjherë, as **asht mymqyn me u ba** (Fsh, Pr. I, 76);

Farz asht m'i ninue dhe **m'i falë** tridhetë dit ramazan (ligjërim dialektor); *Me krye urdhnin asht detyrë* e mos me krye asht tradhti (D. B., Fjalë të urta..., 74);

Prej asaj dite thonë se njerzit rahat nuk po bahen e se u ka hi hasreti n'bark... e **nuk âsht punë me u ba rahat** (Pr. Dren. I, 132); Ky e pa qi **s'âsht punë me u qitë hî syve**, po i duelën tana për fushë (Pr. Dren. II, 69); Mullisi p'e sheh qi ujë kishte ardhë shumë e **s'ish punë me ja blue** grunin... (Pr. Dren. II, 90); — **Nuk âsht punë** qi bahet *per me folë* me pashën, se âsht idht fort... (Fsh, Pr. I, 246); (Katallani rreth përmbrenda, e ky rreh përjashta.) **S'ke punë me e shpërthye**, por u kujtue se ishte ndry mbrendë (Fsh, Pr. II, 253); **S'kje punë me iu kthye mendja** (djalit, T. K.), Por ngarkoi tri mushka me pare e u nis (Fsh, Pr. II, 319);

— Rrini sante se **s'âsht lazëm me dalë** neper kit mot (ligjërim dialektor);

Ky kallëzuesor përdoret më shpesh me foljen *běj*, e cila vihet në vetën e tretë njëjës: (*s'*) *bën lazëm*:

Nuk ban lazëm pare *për me la*, /tre djemt tu, tha, djali si t'i lshon (Këngë kreshnike, 159); **Nuk bani lazëm me dalë** kurrë se i bani zoti çirak shpinë e tyne; Prej asaj dite burri *s' b a n i l a z ë m me e rrehë* ma t'shoqen e grueja u ba e vyeshme e u përmën n'krejt katunin (Pr. Dren. I, 176; 245);

Asht kân droe met *me t'lanë* (Pr. Dren. I, 138); Aqë kadalë ki' me shkue, /se djali i ri ka qillue/ e **asht drojë me ma rrëxue** (Fsh, Ep. legj., 489); Ha gjelpt e pi ujë, **asht droe me plasë**; Me t'metë ashti n'fyt, **asht droe me t'mytë** (ligjërim dialektor);

Aty **ish kân jasad me shkue** me mushë ujë burrat aty (Pr. Dren. I, 61).

Në konstruktet e fundit nga paskajorja tregohet brendia e nevojës, e ndalimit, e frikës.

ç) emrat *gjë* dhe *punë*, të ndjekur nga përcaktorë mbiemra. Si kallëzuesorë këta përdoren vetëm kur janë të shoqëruar me një mbiemër cilësor. Emrat *gjë* e *punë* kanë kuptim shumë të përgjithshëm dhe „shërbejnë akoma vetëm si mbështetje morfologjiko-sintaksore për

mbiemrin”.⁶ Peshën kryesore kuptimore e ka mbiemri në trajtë të femërores. Me anë të kallëzuesit emëror paraqitet vlerësimi cilësor i asaj që shprehet me paskajore; *e rëndë, e lehtë, e vogël, e drejtë, e keqe, e mirë, e rrallë* etj.:

— **Asht** shumë **punë e rânë** m’u bâ mret (Pr. Dren. II, 163); **Nuk âsht punë e vogël** m’i krye dy klasë per ni vjet (ligjërim dialektor); **S’âsht punë e letë** me rritë thmi (ligjërim dialektor); **S’âsht gja e vogël** edhe me rritë thmi, edhe m’i kçyrë rângt e shpisë (ligjërim dialektor).

d) emra me kuptim abstrakt në trajtë të shquar, si: *puna, puna e parë, e para punë, kryesorja*. Këta emra i prijnë zakonisht këpujës *jam (është)*: Tash **puna âsht me marrë** gruen tjetër përtej detit (Fsh, Pr. II, 261); **Caki i burrit âsht m’i nëjt gati** çdo gjâje (Fjalë të urta..., 13) Si n’e paçi ju bukën thatë, /Si n’i paçi shpijat me kashtë,/ **Urdhni i Pashës âsht me na i pru** gratë (K. p. hist., 199).

„Në disa raste është i vështirë përcaktimi i funksionit kryefjalor apo kallëzor i fjalisë, së varur të ndërtuar me fjali kryesore që kanë si kallëzues emëror një emër të vendosur përpara, si: Dhe puna e parë (që duhej bërë) qe të ndizte zjarrë. Të tilla fjali nga disa janë quajtur kryefjalore, ndërsa të tjerë, duke i dhënë rëndësi edhe topikës, pikënisjes së mendimit nga emri, e kanë marrë emrin si kryefjalë dhe fjalinë që pason si kallëzuesore”.⁷

Spiro Floqi nuk është dakord që fjalia e varur në këtë tip periudhash të trajtohet „... daç si kryefjalore, daç si kallëzuesore”; ai pohon pa ngurrim se te periudhat e tipit „e vërteta është” + një fjali me lidhëzën *që a se* (dhe në raste të tjera si *e mira është (që)* + edhe me ish-lidhëzën *të*, (sot pjesëz trajtëformuese e trajtave kohore të mënyrës lidhore) fjalia „e vërteta është”, „e mira është” nuk mund të merret veçse si fjali kryesore, kurse fjalia tjetër si kryefjalore.⁸

dh) me emra në trajtë të shquar të ndjekur nga një mbiemër pronor: *qejfi im, dëshira ime, detyra ime, puna ime*, ku shquarsia e emrit kushtëzohet nga kuptimi i pronorit:

Qefi jem âsht me ruejtë lkurën e, kur t’ethen lopt, *me jau qitë* sipri (Pr. Dren. I, 312); *Dityra jême âsht me punue* tokën, e juja m’i kçyrë pünt e shpisë (ligjërim dialektor);

e) me emrat *udhë, rrugë, derë* e ndonjë tjetër në bashkëvajtje me një përcaktor mbiemër që zakonisht vihet para emrit; emri në këtë përdorim del i pashquar, kurse mbiemri shquhet dhe formalisht merr trajtën e emrit: *e vetmja rrugë, e vetmja udhë, e vetmja derë*. Në këta togfjalësha emrat *udhë, rrugë* dhe *derë* kanë përdorim stilistikor: *e vetmja rrugë, e vetmja rrugëdalje, e vetmja zgjidhje*.

⁶ S. F l o q i, *art. i cit.*, f. 29.

⁷ M. D o m i, *Sintaksa e gjuhës shqipe, II*, konspekt-leksione pregatitur nga Prof. M a h i r D o m i, Tiranë, 1966, 55; botimi i dytë, 1969, f. 57; botimi i tretë, 1975, f. 62. (Shih edhe S t e f a n P r i f t i, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Pjesa e II, Disp. I, Tiranë, 1963, f. 106; ribotimin Prishtinë, 1971, f. 262).

⁸ S. F l o q i, *art. i cit.*, f. 31.

Në këtë kategori mund të futen edhe raste të tjera, ku paskajorja ka të bëjë me emra në bashkëvajtje me përcaktorë sidomos në shkallën krahasore të sipërisë absolute. Zakonisht përcaktori vihet para emrit, duke marrë trajtën e tij. Formalisht emri është i pashquar, por shquarsia i përket emrit dhe jo mbiemrit: *vdekja më e madhe: më e madhja vdekje:*

E vetmja derë është qi mos m'e marrë rrogtari çikën tâne... (Pr. Dren., 110); *E katërta dekë është me t'dekë* akrabat tu, qi ke nëjë me ta, e t'bjën me nejë me disa tjerë e ata s't'pranojnë n'shoqni e nuk ki kur rrin (Pr. Dren. II, 271); *Ma e madhja dekë është me dekë* pa dekë (Pr. Dren. II, 41); Njeri i ka katër dekë për s'gjalli, para se me nrrue jetë: *Ma e para dekë është me sunue* i dohti, i padishmi, i ligi... (Pr. Dren. II, 271); *Rrëna ma e madhe*, baco, *është me kallxue* shka t'nish (Fjalë të urta, 115); *Detyra ma e parë e njerit është me ja ditë* hallin vetit (aty, 15); I smuti ka niqin e ni dëshirë, po ajo *ma e madhja është me b'â mirë* (Fjalë të urta..., 38); *Budallaku ma i madh është me lshue* gruen me thmi (ligjërimit dialektor).

Në këto konstrukte vleftat kuptimore të të dy kraheve krijojnë një problem të ndërlikuar, i cili diskutohet jo vetëm në gramatikat e shqipes, por edhe në gramatika gjuhësh të tjera. Këtu, siç thotë S. Floqī, duhet përcaktuar së pari se cila fjalë është objekt predikacioni: emri në trajtë të shquar apo brendia që shpreh pjesa e varur. Si rrjedhim, edhe paskajorja duhet marrë në funksion kryefjalor, sepse ajo që shprehet me të, klasifikohet nëpërmjet nocionit më të përgjithshëm „*detyra e parë*”, „*puna kryesore*”, „*rrëna më e madhe*”, „*më e madhja vdekje*” etj.; në këto konstrukte, pra, shprehen marrëdhënie midis së përgjithshmes dhe së veçantës.

ë) me emër në rasën gjinore: *është e udhës, është e rrugës:* Darsum kena shok milic!) *Nuk është e udhës me n a k t h y e te prap* (ligjërimit dialektor);

f) me emrin *merak* si kallëzuesor të foljes gjysmëkëpujore *bëhem* dhe *mbetem:*

Berberit iu ba marak me nie djalit (Pr. Dren. I, 98); *Mue m'u ka ba marak m'e pre* Larën (Pr. Dren. I, 36); Po sikour e xhexhi couca muhabetin e pashës me të jatin, i *u ba marak me e n j o f t ë* këtë njeri, se i shkante llapa aqe ku i dhëjmte dhambi (Fsh, Pr. II, 10); At'herë djalit i *bahet marak me e çelë* edhe at sobë qi ja kish nalue plaku (Pr. Dren. I, 107).

Si u nis Ouha-ja, djalit i *mbet marak me dijtë* se shka do të kishte ajo odë, për të cillen e kishte porositë i zoti i shpisë mos me e çilë (Fsh, Pr. II, 150);

Shprehja (*më*) *bëhet merak* shpesh vihet në korrelacion me një kryefjalë në fjali të pavarur, gjë që tregon se edhe paskajorja është në funksion kryefjalor: Çish at dekeëjkë gjalit *ju bo merak kjo fjalë* en neëjси me mendouë për motrën e shtat difave (Fsh, Pr. II, 83); *Agait ju bo merak kjo puna* e Dinit (Fsh, Pr. II, 100).

Përkundrazi, kur folja është vetore, atëherë paskajorja është në funksion kundrinor; kësaj i përgjigjet një kundrinë e zhdrejtë me parafjalë: *U bana merak me t'pa.*

2) Kallëzuesi emëror ka si kallëzuesor një mbiemër

Kallëzuesorët mbiemra tregojnë cilësi, veti, tiparë; kallëzuesori mbiemër i kallëzuesit emëror i jep brendisë së shprehur nga paskajorja një vlerësim nga pikëpamja e kuptimit leksikor të vetë mbiemrit.⁹

Paskajorja ka të bëjë:

a) me mbiemra që përdoren për të vlerësuar nga pikëpamja modale e mundësisë ose e pamundësisë atë që shpreh paskajorja. I tillë është kallëzuesori *e mundur*; në vend të kallëzuesorit *e pamundur* të gjuhës letrare, përdoret forma mohore me pjesëzat *s'*, përkatësisht *nuk*; (*s'*) është *e mundur*:... *n'koftë e mujtun me* ma **dhânë** ti qit djalë, ta kisha dhânë ni bakshish *t'madh* (Pr. Dren., 10); — Mirë — tha — a *âsht e munme me kabue*, me ma pru mu ka, thuj qi janë plaçka të nukura, t'mira shumë (Fsh, Pr. III, 369); — Kqyr, — i thotë plaka — se kta e kanë zanat edhe desin n'gjum, se *nuk âsht e mujtne me fjetë* kaq vonë (Pr. Dren. I, 57);

b) me mbiemra që vlerësojnë brendinë e paskajores nga pikëpamja e nevojës:

Per ksi rastesh *nuk âsht e nevojshme m'u idhnue*, se rritet sherri (ligjërim dialektor); — Edha hâ, — i thot, — kto dy lira se per ty *â kân e nevojshme m'u lutë* aq shumë (Pr. Dren., 131);

c) me mbiemra që tregojnë vlerësim moralo-etik: *e drejtë, e padrejtë*:

Nuk âsht e drejtë atîna me i ra hâm shpija, hâm pasllâmi (ligjërim dialektor); U nalën e ja kallxuen krejt punën e e vetën a *âsht e drejtë me e hangër* gjarpni drumtarin (Pr. Dren. I, 296);

ç) me mbiemra që vlerësojnë brendinë e paskajores nga pikëpamja e vështirësisë:

(— O s'ka ma mirë!) Po *s'qenka* aq *e vështeejre* me fja roue (Fsh, Pr. I, 103);

3) Kallëzuesi emëror ka si kallëzuesor një përemër

Si kallëzuesorë të kallëzuesit emëror shërbejnë edhe disa përemra, si: *gjë, kurrgjë, çka (shka)*. Kallëzuesi emëror, që ka si kallëzuesor përemra *gjë* dhe *kurrgjë*, zakonisht përbën fjali mohore:

S'âsht gja me xjerrë ujë prej gurit, por a je i zoti me xjerr tambël prej gurit (Fsh, Pr. II, 270); **Me e vra** ni herë, *nuk âsht kurrgjâ*, me e vra perditë kenka zor (Pr. Dren. II, 257); (— Kurrgjâ s'paske bâ.) *Shka âsht me hekë*

⁹ S. F l o q i, art. i cit., f. 32.

ni kungj viçi? (Pr. Dren. I, 135); Z'di ti *shka* **është mos me pasë** grue (ligjërim dialektor).

4) Kallëzuesi emëror ka si kallëzuesor një ndajfolje

Në funksion kryefjalor mund të trajtohet paskajorja edhe pas shprehjeve pavetore, ndërtuar nga folja këpujore *jam* në vetën e tretë njëjës: *është* + *ndajfolje*.

S. Floqi rastet e togjeve *është* + *ndajfolje* i përjashton nga rastet e një kallëzuesi që kërkon domosdo fjali të varur kryefjalore, sepse, sipas tij, nuk vihet dot një bashkëlidhje drejtpërdrejtë midis tyre dhe ndonjë kryefjale gramatikore.¹⁰ Ashtu si edhe shprehjet pavetore *më vjen keq*, *më vjen mirë*, *më vjen rëndë*, *më vjen çudi* etj., edhe shprehjet në shqyrtim, sipas Floqit, janë më tepër shprehje pavetore dhe si të tilla nuk marrin dot kryefjalë, as fjali kryefjalore, prandaj duhen përjashtuar nga tipet e periudhës me fjali të varur kryefjalore.

Ne na duket se pranë shprehjeve *është mirë*, *është keq*, *është herët* etj. paskajorja mund të trajtohet në funksion kryefjalor, sepse në ndonjë rast mund të vihet njëfarë lidhje midis tyre dhe ndonjë kryefjale gramatikore: *S'është mirë kjo gjë*; *S'është keq kjo gjë*. Përkundrazi, te ndërtimet *më vjen keq* etj., paskajorja duhet trajtuar në funksion kundrinor të zhdrejtë: *më vjen keq për këtë gjë*.

Paskajorja ka të bëjë pra:

a) me ndajfoljet *mirë*, *keq* që vlerësojnë brendinë e paskajores si diçka të mirë, të keqe:

Nuk asht keq kajherë **mw** i **ngue** gratë... (Pr. Dren. II, 61); (-Aj zotoet se të shëndoshën). Qun thom se *nuk është keq me bo provë* (Fsh, Pr. II, 130); — *A është mirë me ngue* gruen? (Pr. Dren. II, 61); *A është mirë* me t'ra ty n'krye? — edhe i ra e e myti (Pr. Dren. I, 136); — He — thot njani vlla — *ktâ është kânë mirë me e marrë* edhe me e pre, m'e shti edhe me e zie, e me hangër kryet (Pr. Dren. I, 132); Mreti e knoi letren edhe e pa qi kjo punë ish ba e *s'ish mirë me e ba* punën t'madhe (Pr. Dren. I, 61); — *A merr vesht*, Maliq Bylykbashi? /Këto male të këqija janë qillue,/ shke t'panumur këtu rrijnë, /na *asht mirë për më u da/* e ktu shkjetë mos me i lëshue (Ep. legj., f. 482).

b) me ndajfoljet *letë*, *kollaj*, *vështirë*; këtu do të grupojmë edhe emrin *zor*:

Kanun është letë me bâ, kur njeri ni dorë e ka n'drejtsi e ni n'njerzi edhe të dyja n'zemër (ligjërim dialektor); — *Nuk asht letë* Uroshin **me e pre**,/ se në midis detit ka shpinë dymbëdhetë kat (Ep. legj., 481);

Nuk është kollaj m'i shkoqë dorzant (pr. Dren. II, 201); *Ish kollaj*, bre babë, **me e lanë** duhanin (ayt, 23); — Tjetër guna e tjetër Lule Frangu!/
 10 S. Floqi. *art. i cit.*, f. 11.

Pse kollaj ty asht për me t'njoftë (Ep. legj., 343); — A merr vesht, or Qetobash Muja?.../ Sod po i ndrrojnë krajlijat dy çika.../ Fort kollaj asht çikat me ja u marrë (Ep. legj., 384);

— Mor jo, — tha — nuk ish shtirë me nejë n'vorr, veç me i trëmë kualt e qiraxhive ish shtirë (Pr. Dren. II, 64); Nuk â vshtirë një krajl me pre/ dhe nusen robinë me ja marrë... (Ep. legj., 295);

— E m'ò, bacë, se kur t'vjen Bislim aga, âsht zor m'e pritë (Pr. Dren. II, 82); Kam çef, nanë, me m'kallxue a âsht zor me e ba thminë? (Pr. Dren. II, 185); ... kjo e kishte msheh n'bir t'huns myhyrin, e ishte zor me ja nxjerrë (Fsh, Pr. II, 251); Rrokne kangën për me knue,/ se ish kanë zor dy nuse me i lshue (Bal. dhe legj., 87); Si mos u kthefshim, nanë, për shtatë vjet,/ Grat'e tona ktheni për kunet!/ N'u left djalë, nanë, prëne n'djep./ Fort zor koka m'e ba kët hyzmet! (Këngë pop. hist., 54).

Në rastet kur shoqërohet me një përcaktor, atëherë fjala zor është emër: — Unë ni çeshme, Halil, qi e di, /zor i m a d h asht ujë, bre, n'tâ me pi (Këngë kreshnike, 191).

Kallëzuesorët e mësipërm mund të kenë si këpujë ndonjëherë foljet bëhet, (më) duket, (më) vjen, të cilat në këtë përdorim mund të konsiderohen si folje gjysmëkëpujore: Pra ju duk ma mirë m e j a p a g u e paret e ja dha dy lira t'zot t'kaut (Pr. Dren. II, 244); M e d h a n ë jetën na duket letë/ Eee, more me partinë do t'jem përjetë (Këngë pop.) Ma let m'vjen me prashitë xhith ditën pa nâl, se m'i rujt xhân ni sahat (ligjërim dialektor); — Aman jarabi, u ba zor m e f o l ë edhe me veti (pse kujtori qi katunari e kish gjuejtë pse e kish nie tuj folë vet me veti (Pr. Dren. I, 305).

Kallëzuesori del para këpujës, sidomos kur prihet nga ndajfolja e shkallës krahasore:

— O Deli Gashi, a ma mirë âsht me kanë n'tokë t'zotnisë apo n'tokë tâne e t'lig? (Pr. Dren. II, 176); Ma kollaj âsht me vjedhë ditën a natën? (Pr. Dren., 74); — Jo valla — tha — ma mirë âsht niherë me thânë „hiç”, se perditë „kiç, kiç” (Pr. Dren. II, 124); Ma letë âsht me zgidhë kët grue prej telit qi e ka lidhë dreqi rreth veti, se me ia nxierr lops viçin prej barkut (Pr. Dren. I, 144); Zor âsht me m'shti mue n'thes (ligjërim dialektor); — Kollaj asht kanë me ditë kët punë, se gjithë kerri praptohet n'anë t'poshtër e jo n'anë t'epër (Pr. Dren. II, 172).

Rendi i anasjelltë „paskajore + kallëzues emëror” përcaktohet nga arsye stilistikore dhe nga gjymtyrimi aktual:

Me hi âsht kollaj, por me dal âsht zor (Pr. Dren. II, 126); — Vetëm pesë a gjashtë — tha plaki, se me mlue âsht zor (Pr. Dren. II, 225).

Paskajorja në funksion kryefjalor mund të jetë edhe pranë fjalës një: Me menue e mos me bâ, nuk âsht një (= njësoj, e njëjta gjë) (Fjalë të urta..., 75).

Tafil Kelmendi

L'INFINITIF EN FONCTION DU SUJET

R é s u m é

Dans cet article qui est un fragment détaché de l'étude „les fonctions syntaxiques des constructions avec l'infinitif au parler populaire et dialectal” /principalement sous la base des matériaux folkloriques/, on décrit les cas de l'utilisation de l'infinitif en fonction du sujet. Pour définir la fonction du sujet de l'infinitif, Tafil Kelmendi se base à la classification fonctionnelle, dont la source est au sens logique-grammatical. Il s'en tient au critère du parallélisme des fonctions des propositions subordonnées avec celui des éléments de la proposition qui est le plus répandu à la grammatologie albanaise.

L'auteur donne tout les cas possibles de l'utilisation de l'infinitif du type guègue, se basant sur la signification lexicale et grammaticale du premier élément principal des constructions.

L'étude est partagée en quatre chapitres. Au premier chapitre on donne les cas de l'utilisation de l'infinitif près d'un verbe transitif de la voie passive. Dans ce chapitre on a groupé les verbes avec une signification lexicale de *la communication*, *de la perception sensitive*, *de la perception mentale* et *du processus mental*, *du désir* et *de l'expression de la volonté*, qui, à la troisième personne du singulier prennent l'infinitif en fonction du sujet.

Le deuxième chapitre traite les cas de l'utilisation de l'infinitif près d'un groupe de mots formé d'un verbe transitif et d'un nom à la forme indéfinie, tandis qu'au troisième chapitre on donne l'utilisation du sujet près d'un verbe intransitif.

Le quatrième chapitre traite les constructions avec l'infinitif, quand ce dernier relève d'un sujet exprimé par un *nom*, par un *adjectif*, par un *pronom* et par un *adverbe*. On classifie ces sujets en petits groupes selon leur signification lexicale.

